



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër
12- Zyrtarisht /2023
Deçan, 07.07.2023

Për: Kryetarin e Komunës së Deçanit
Z. Bashkim Ramosaj

Përmes: Drejtorit të Drejtorisë **Z. Agron Muslijaj** _____

Nga : Shefi i Drejtorisë **Z. Hasan Hulaj** _____

Lënda: Raport Pune për periudhën Gjashtë Mujore nga data **01.01.2023 – 01.07.2023**, i Drejtorisë
për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Deçanit

Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe Raportin e punës për periudhe gjashtë mujore nga data **01.01.2023 – 01.07.2023** për Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit në Deçan

R A P O R T P U N E

Për periudhën gjashtë mujore nga data 04.01.2023 – 01.07.2023 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan

1. Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referentin e ndryshimeve kadastrale

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë përkatësisht prej fillimit të vitit 2023 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti , Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsejtë **260** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri me tani janë shqyrtuar **256** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate me të cilat palëve iu është njohtë e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa **4** kërkesa janë në procedurë e sipër.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohtë e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referenti për ndryshime kadastrale i cili konform këtyre vendimeve dhe aktvendimeve të terrenit bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjta prapë i azhuron duke i fut këto të dhëna në programin e SIKTK-es

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronësoro juridike si dhe së bashku me Referentin për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit .

2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit

Këta zyrtar gjatë periudhës raportuese i kanë pasur **125** azhurime të lëndëve nga tereni sipas kërkesë së palëve siç janë : Ndarja e parcelave, Bashkimi i parcelave, Regjistrimi i Objekteve, korigjimi i sipërfaqeve, korigjimi i mexhave dhe futja e të dhënave të reja në sistem etje. Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **4** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër. Pas azhurimit të këtyre lëndëve këta zyrtarë kane lëshuar për secilin rast aktvendim përkatës .

Gjithashtu këta zyrtar gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **2** historiate dhe identifikime të mexhave sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **269** kopje plani.

Gjatë kësaj periudhe raportuese këta zyrtar kanë dal në teren për **2** raste nga domeni pronësoro juridik e sipas kërkesës zyrtare të bërë nga ana e Komunës së Deçanit, për nevoja të Komunës.

Të kanë kryer edhe detyra tjera sipas nevojave të cilat paraqiten në këtë shërbim siç janë konsultat me palë dhe punë tjera në zyre.

3. Referentja për pranimin e palëve

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referentja për pranimin e palëve ka pranuar gjithsejtë **1541** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e Komunës.

E njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës. E njëjta punëtore krahas këtyre punëve ka kryer edhe punët e përpunuesit në SIKTK.

Për hir të thjeshtësimit të të dhënave për punët e kryera të këtyre punëtorëve këtij raporti po ja bashkangjesim edhe formën tabelare të lëndëve të pranuar sipas muajve konform kërkesave të palëve .

Lloji i lëndëve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
Aktvendimet për ndryshime Kadastrale	048	048	045	039	048	032	0260
Azhurimi i lëndëve – tereni:	010	021	022	019	034	019	0125
Lëshuarja e Kopjeve të planit :	023	030	048	047	055	043	0246
Lëshuarja e Certifikata dhe vërtetimeve:	219	294	303	215	298	212	1541
Totali për Muaj	300	393	418	320	435	306	2172

Sipas kësaj del se Kjo drejtori gatë kësaj periudhe bazuar në kërkesat e palëve ka lëshuar gjithsejtë 2164 dokumente Valide dhe në procedurë janë edhe 8 kërkesa.

Kjo Drejtori krahas këtyre punëve të evidentuara më lartë ka kryer edhe punë tjera të parashtruara konform kërkesave të palëve private dhe organeve komunale.

Raportin e përpiloi :
Shefi i kësaj Drejtorie
Hasan Hulaj

D r e j t o r i
Agron Muslijaj